



LIBERALIZIMI I TREGUT TE ENER GjISE ELEKTRIKE

**Kost-benefit analize per politike publike:
liberalizimi i tregut te energjise elektrike per
harxhimin e mjeteve buxhetore duke studiuar
rastin dy komunave te shkollat**



Stërvitje:

Autore

Rozalija Vasilevska, Instituti per zhvillim dinamik Sfera Nova

Mentorë

Natasha Trajkova¹ – Fakulteti ekonomik, Prilep

Përktheu

Lirim Hajredini

¹ Qëndrimet e shprehura në studimin janë qëndrime të autorëve dhe mentorit jo domosdoshmërisht pajtohet me të njëjtat

SHKURTESA

CBA	Analizë e harxhimeve dhe përfitimeve
GWh	Gigavat orë – njësi matëse për energji elektrike
EVN	Rrjeti elektrodistributiv
EDS	Energy Delivery Solutions EDS SHPK
MWh	Megavat orë – njësi matëse për energji elektrike (1000 MWh = 1 GWh)
MEPSO	Sistem operatori për elektro transferim i Maqedonisë
NN	Tension i ulët
UKIM	Universiteti “Qiril dhe Metodij” - Shkup

HYRJE

Që nga fillimi i liberalizimit të tregut për energji elektrike nga viti 2011, rreth 250-260 kompani të cilat janë shfaqur në tregun e lirë për energji elektrike në Maqedoni kanë harxhuar rreth 850,000 MWh energji elektrike. Çmimin të cilin këto kompani e kanë paguar para liberalizimit ka qenë mesatarisht rreth 95 EUR/MWh kurse pas liberalizimit mesatarisht kanë paguar rreth 70 EUR/MWh. Kjo donë të thotë se mesatarisht çmimi i energjisë elektrike është zvogëluar për 25 EUR/MWh. Harxhimi prej 850,000 MWh për kompanitë paraqet kursim prej rreth 20 milionë EUR që nga fillimi i liberalizimit deri tani.

Qëllimi i kësaj analize është të shihet vallë shembulli i më lartë a do të vlejë edhe për harxhimin e energjisë elektrike në institucionet publike, gjegjësisht institucionet të cilat harxhojnë të holla publike për ti paguar faturat për energji elektrike. Është përpiluar studim konkret me dy komuna në Maqedoni në bazë të dhënave për konsumim të energjisë elektrike në shkolla (institucione publike) në nivel vjetor. Janë marrë parasysht dy opsione A dhe B ndërsa çmimet e energjisë elektrike janë marrë nga operatorët dhe Komisioni rregullator. Në qoftë se këto institucione publike dalin në tregun e lirë për energji elektrike dhe zgjedhin furnizues sipas dëshirës është evidente se do të kursejnë edhe atë prej 29.56% deri 36.98% (Opsioni A dhe Opsioni B i çmimeve marrë nga operatorët dhe Komisioni rregullator) – nënkuptohet nëpërmjet procedurës publike për tenderim. Paret publike për energji elektrike në përgjithësi harxhohen në dy nivele: institucione publike dhe ndërmarrje publike.

Ndërmarrjet publike si subjekte juridike (ndërmarrje) dalin në tregun e lirë sipas kriteve të përcaktuara në Ligjin për energjetikë (Службен весник на РМ бр. 16/2011) dhe Rregulloren për tregun e energjisë elektrike (Службен весник на РМ бр. 162/2009).

Për dallim nga ndërmarrjet, institucionet publike janë në të ashtuquajturën zonë gri të ligjit, ata ligjërisht kanë të drejtë të zgjedhin furnizues por në praktikë nuk vendosin lehtë sepse jo rrallë kanë borxhe për fatura të papaguara për energji elektrike. Historikisht

bëhet fjalë për institucione të cilat rëndë paguajnë dhe prandaj nuk dëshirojnë të dalin në tregun e lirë që të mos kenë problem me furnizimin në raste kur kanë borxhe të mëdha për energji elektrike dhe nuk mundën ti paguajnë. Momenti i tolerancës nga ana e EVN-s është njëri nga faktorët i cili i demotivon këto institucione që të dalin në tregun e lirë të energjisë elektrike. Sidoqoftë pozicioni i tillë i këtyre institucioneve nuk e zgjedhën çështjen e borxheve por përkundrazi e akumulon problemin dhe e zmadhon problemin.

Ndarja e këtillë të institucionet publike bëhet sipas asaj a janë nën kompetenca të pushtetit lokal apo atij qendror.

Nga buxheti qendror dhe nën kompetenca të pushtetit qendror janë institucionet publike në vijim:

- Kuvendi i RM-s
- Qeveria e RM-s me të gjitha ministritë dhe njësitë rajonale
- Arsimi i lartë (shtetëror)
- Institucionet shëndetësore (spitalet dhe ambulancat)
- Institucionet parashkollore (foshnjoret, qendrat për pranim, kopshtet për fëmijë, institucionet për fëmijë pa prind, etj)
- Policia
- Ushtria
- Doganat
- Drejtoria për të hyrat publike
- Gjyqësia (në mënyrë indirekte nëpërmjet buxhetit për gjyqësi
- Agjencitë shtetërore, organet në kuadër të qeverisë/ministrive
- Organet e pavarura rregullator
- Byrotë shtetërore
- Administrata shtetërore
- Institucionet nga fusha e shkencës, kulturës dhe artit

Nga buxheti lokal gjegjësisht nga vetëqeverisja lokale financohen institucionet në vijim:

- Shkollat e mesme
- Shkollat fillore
- Ndërtesat komunale
- Ndrëçimi rrugor
- Shtëpitë e kulturës

Sic tha ish ministri i ekonomisë Saraçini në një prononcim për mediat (Непознат автор, 2013), nga harxhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike në sektorin publik 23% e harxhimit të përgjithshëm i takon shkollave.

Objekt i analizës në këtë studim është **Analiza e harxhimeve dhe përfitimeve (CBA) për politikë publike – liberalizimi i tregut të energjisë elektrike për harxhimin e mjeteve buxhetore duke studiuar shkollat në dy komuna**. Shkaku kryesorë që shkollat janë në fokusin e analizës është mundësia për të marrë të dhëna të sakta, precize dhe relevante për të njëjtat. Sipas Ligjit për financim të njësive të vetëqeverisjes lokale (Министерство за финансии, 2004) shkollat për harxhimet e tyre për energji elektrike, mirëmbajtje, ndriçim, ngrohje dhe nevoja tjera financohen me bllok grante nga buxheti qendror i cili pastaj menaxhohet dhe realizohet nëpërmjet vetëqeverisjeve lokale. Në atë pjesë këto harxhime të shkollave trajtohen si harxhim i parave publike sepse të njëjtat vijnë nga buxheti qendror dhe mbliidhen nga tatimet e qytetarëve dhe kompanive.

Në fokusin e hulumtimi tonë është konsumimi i energjisë elektrike në shkollat fillore dhe të mesme në nivel komunal. Në bazë të të dhënave me saktësi të lartë mundemi të njehsojmë sa para publike do të kursenim nëse këto institucione fillojnë të furnizohen me energji elektrike në tregun e lirë. Në këtë drejtim mundet të krijohet edhe një *kalkulator* nëpërmjet të cilit institucionet e interesuara do ti japin të dhënat për konsumimin e energjisë elektrike, në bazë të të cilit do të njehsohet sa është kursyer. Për nevojat e CBA-s janë shfrytëzuar të dhëna nga dy komuna nga të cilat njëra është urbane – Komuna e Koçanit me 10 ndërtesa shkollore (5+4 shkolla fillore dhe 1 shkollë të mesme), të dhëna për vitin 2012, 2013 dhe 2014 dhe një komunë rurale – Komuna e Krivogashanit me 1 ndërtesë shkollore (1 shkollë fillore) për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

FAKTE PËR POLITIKËN DHE GJENDJEN

TREGU I ENERGIJË ELEKTRIKE DHE PJESËMARRËSIT

Në Republikën e Maqedonisë në tregun e organizuar të energjisë elektrike marrin pjesë prodhues, konsumatorë dhe kompani që merren me tregtinë e energjisë elektrike. Sistemi operatori elektropërçues i Maqedonisë – MEPSO është kompani në pronë të plotë shtetërore e formuar në vitin 2005 me transformimin e Elektroekonomisë së Maqedonisë. Veprimtaria themelore e MEPSO-s është transferim pandërprerë i energjisë elektrike nëpërmjet rrjetit të tensioni të lartë dhe përcjellja e rregullt dhe në kohë e energjisë elektrike deri te klientët e vet: *konsumatorët e drejtpërdrejtë* (Buçim, OKTA, Makstil, Arçelor Mital, Jugohrom Feroalojs, Legurat e Shkupit, Feni Industri, Hekuru-dhat e Maqedonisë) dhe deri te *rrjeti për distribucion* i EVN Maqedonisë. Secili nga këto pjesëmarrës është i evidentuar në regjistër të veçantë në MEPSO:

- Regjistri i pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike
- Regjistri i grupeve përgjegjëse të balancuara
- Lista e prodhuesve preferencial të energjisë elektrike (sisteme fotovoltare)
- Lista e prodhuesve preferencial të energjisë elektrike (centrale hidroelektrike)
- Lista e fuqisë së instaluar të prodhuesve preferencial sipas llojit të centralit

Në pjesën e konsumatorëve, sipas Ligjit për energjetikë (Службен весник на РМ бр. 16 /2011), Neni 197, në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë konsumatorë tariforë dhe konsumatorë të kualifikuar. Konsumatorë tarifor janë amvisëritë, shkollat, komunat, spitalet, etj.

Fotografia 1.

Karta elektro energjetike e Maqedonisë



TREGU I LIRË I ENERJISË ELEKTRIKE

Energjia elektrike të cilën e harxhojnë kompanitë, ndërmarrjet publike/institucionet, shkollat, spitale të cilat kanë dalë në tregun e lirë blihet nëpërmjet bursave ndërkombëtare të energjisë elektrike. Pasi që furnizuesi ta ketë blerë dhe transportuar energjinë elektrike deri në Maqedoni, energjia elektrike patjetër të kalon në rrjetin e MEPSO-s dhe rrjetin elektrodistributiv të EVN-s që të mundet të distribuohet deri te konsumatorët/shfrytëzuesit final. Për transferimin dhe distribucionin e tillë të energjisë elektrike deri te konsumatorët final, pos harxhimit për furnizim të energjisë elektrike paguhet edhe e ashtuquajtura taksë e distribucionit ndaj operatorit të sistemit të distribucionit. Ky harxhim e përmban taksën për rrjetin e transferimit dhe rrjetin e distribucionit.

Kjo energji elektrike e cila blihet dhe transportohet duhet paraprakisht të planifikohet sipas sasisë dhe kohës kur dot blihet. Nëse konsumi real devijon nga ai i planifikuari atëherë dallimi duhet të balancohet nga ana e operatorit për transferim. Devijimeve nuk mund të shmangen por mundet të zvogëlohen me planifikim të saktë dhe konsolidime grupore.

FURNIZUES ME ENERGI ELEKTRIKE NË TREGUN E LIRË

Sipas rregullave ekzistuese ligjore konsumatori mundet të zgjedh furnizues të ri me energji elektrike dhe për atë duhet të kërkon ofertë për furnizim, ti shqyrton kushtet e ofruara dhe të sjell vendim nga cili furnizues dëshiron të furnizohet me energji elektrike

Grupi i Energy Delivery Solution – EDS është njëri nga operatorët e regjistruar të energjisë elektrike te operatori i tregut në Maqedoni dhe siguron çmime më të lira të energjisë elektrike nga EVN-ja dhe nga shumica e furnizuesve tjerë si edhe kushte më të mira për furnizim.

Liberalizimi rezulton me ndarjen e përgjegjesisë korporative mes distribucionit të energjisë elektrike dhe prodhimit.

Globalizimi energjetik ka të bëjë me liberalizimin e tregut energjetik, me theks të veçantë në tregun e energjisë elektrike, me atë që konkurrenca më e madhe në tregjet e energjisë elektrike dhe gazit në interes të krijimit të tregjeve më konkurrencte dhe uljen e çmimit. Pasi që furnizimi me energji elektrike është monopol natyral kjo nënkupton sisteme të ndërlikuara dhe të shtrenjta për menaxhim që të zbatohet sistemi i konkurrencës.

Të cekim se sipas Ligjit të fundit për Energjetikë nga viti 2011 (n. 4– shih Shtojcën 2), ata konsumatorë të cilët nuk janë të lidhur drejtpërdrejtë në stacione transformuese (LV1.2) kurse janë të tensionit të ulët (NN), dhe të cilët nuk janë ndriçim publik (LV1.1) bëjnë pjesë në grupin LV2. Në analizën tonë ndërtesat shkollore janë konsumatorë të kategorisë LV2.

ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREGUN E LIRË JANË MË TË ULËTA

Rregulla e tregut të lirë ekonomik thotë se *Çmimet çdoherë ulen kur mundësohet konkurrencë në cilin do qoftë segment të tregut*. Tregu i lirë për energji elektrike në shumë aspekte është i ngjashëm me tregun e shërbimeve mobile, telefonike dhe internet. Kur tregu i shërbimeve të telekomunikacionit ishte i mbyllur për konkurrencën, shfrytëzuesit e telefonisë fikse dhe mobile paguanin shumë para vetëm për të marrë numër apo SIM kartelë. Sot, kur konkurrenca është e madhe, SIM kartela mund të blijë në qoshqe, kurse me çdo TV apo paket interneti fitoni numër fiks pa pagesë madje edhe aparat pa pagese.

Shumë ngjashëm është edhe me tregun e energjisë elektrike. Furnizuesit me energji elektrike orvaten të blejnë energji elektrike sa më të lirë dhe në mënyrë më të lirë ta sjellin energjinë elektrike deri në Maqedoni. Në princip, jo vetëm praktika ekonomike por edhe teoria ekonomike sugjeron se ndryshimi i strukturës tregtare nga monopoli në konkurrencë ndiqet me rënie të çmimit të atij shërbimi (Фити, 2009).

GJENDJA MOMENTALE ME LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË MAQEDONI

Deri më 15 nëntor 2014 ishte afati deri kur të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duhet ta përcaktojnë furnizuesin e tyre me energji elektrike dhe të firmosin kontrata për furnizim me energji elektrike në periudhë prej 1 (një) vjet. Më 8 tetor të vitit 2014, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e anuloi dhe e ndryshoi ligjin për liberalizim dhe zbatoi pesë faza për liberalizimin e mëtutjeshëm të tregut të energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë edhe atë:

1. Në fazën e parë prej 1 qershori 2016 në cilësinë e konsumatorit të kualifikuar do të jenë konsumatorët të cilët në vitin 2015 kanë realizuar konsumim të energjisë elektrike prej mbi 1.000 megavat orë. Në këtë kategori bëjnë pjesë rreth 100 konsumatorë me harxhim të përgjithshëm prej 300 gigavat orë energji elektrike.
2. Faza e dytë do të fillojë më 1 korrik 2017 kur konsumatorë të kualifikuar do të bëhen kompanitë me harxhim të përgjithshëm prej mbi 500 megavat në vitin 2016, gjegjësisht rreth 150 konsumatorë me harxhim të energjisë elektrike prej 300 gigavat orë në vit.
3. Në vitin e ardhshëm (qershor 2018) në tregun e lirë të energjisë elektrike do të këmjen konsumatorët të cilët harxhojnë 100 megavat energji elektrike apo 900 konsumatorë.
4. Më 1 korrik 2019 kur konsumatorë të kualifikuar do të bëhen konsumatorët të cilët harxhojnë mbi 25 megavat orë në vitin 2018, më saktë rreth 3.500 subjekte të cilët harxhojnë 300 gigavat orë në vit.
5. Dhe faza e fundit do të fillon me 1 korrik 2020 kur do të liberalizohet tregu për 65.000 konsumatorë të vogël dhe 600.000 amvisëri me harxhim të përgjithshëm vjetor prej rreth 3.200 gigavat orë.

Sqarimet e dhëna nga ministri Neziri i cili theksoi se *“...Maqedonia deri tani liberalizoi 44 për qind të tregut të energjisë elektrike dhe është në krye të vendeve të cilat e liberalizojnë tregun e energjisë elektrike. Shqipëria deri tani ka liberalizuar 13 %, Bosnja dhe Hercegovina 8 % të tregut të energjisë elektrike kurse Kosova dhe Ukraina akoma nuk kanë filluar. Mali i Zi ka liberalizuar 24% të tregut, Moldavia 3% ndërsa Serbia vetëm 7 %”. „Faza e mëtejshme e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike pritet të mundëson mbrojtje më të madhe të kategorive amvisëri dhe konsumatorë të vegjël. Duke i ndjekur lëvizjet në sektorin energjetik në rajon dhe më gjerë, mund të pritet rritje të çmimeve të energjisë në tregun e hapur duke pasur parasysh faktin se te ne çmimi i energjisë elektrike ka një notë sociale, por më e rëndësishmja është ti mbrojmë qytetarët nga shoku eventual i çmimeve”.*

Nga ana tjetër, kryetari i EEZ, Janez Kopaç me rastin e anulimit të liberalizimit reagoi me deklaratën në vijim të dhënë në tetor 2014: *“Jam i shokuar nga ky vendim, sepse ne aspak nuk ishim të informuar edhe përpos partneritetit të cilin e firmosëm me Ministrinë e ekonomisë dhe me Komisionin rregullator për energjetikë në vitin 2011”. Po ashtu edhe ekspertët reagues në linjë të njëjtë me EEZ. Një nga ato Atansko Tuneski, profesor në Fakultetin e makinerisë në UKIM dhe ish drejtor i MEPSO-s, pohon se anulimi i procesit nuk është në interes të mbrojtjes së çmimit të cilin duhet ta paguajnë qytetarët. „Qytetarët në të ardhmen do të paguajnë çmime të njëjta, pa marrë parasysh të zbatimit apo anulimit të liberalizimit. Muajt e fundit këtë e theksonin edhe institucione relevante dhe persona nga sektori i energjetikës – Komisioni rregullator për energjetikë, furnizuesit me energji, medime dhe përfaqësues qeveritar, të cilët i motivonin kompanitë e vogla të kyçen në proces duke pohuar se llogaritë e tyre për energji elektrike do të jenë për rreth 30% më të ulëta, duke mos ndikuar në faturat e energjisë elektrike të qytetarëve. Edhe një dëshmi se anulimi nuk është në interes të mbrojtjes së qytetarëve është fakti në vijim: në maj të këtij viti u zbatua hapi i dytë i liberalizimit me çka 222 kompani në Maqedoni të cilat kanë qarkullim mbi 10 milionë denarë dhe mbi 50 të punësuar filluan të blejnë energji elektrike në tregun e liberalizuar. Me këtë në nivel vjetor kanë kursyer rreth 14 milionë euro njëkohësisht kjo nuk ka ndikuar në rritjen e faturave të energjisë elektrike për qytetarët. Në fund, pas vendimit të Qeverisë ta anulon këtë proces dhe EEZ në reagimin e vet vërteton se liberalizimi nuk do të shkaktonte çmime më të larta për qytetarët”.*

Për tu dhënë një orientim se ku ndodhet vendi ynë në krahasim me vendet tjera me status të vendit kandidat për UE si edhe me vendet anëtare të BE-s janë bërë analiza krahasuese për konsumimin e energjisë, për çmimet në kategorinë konsumatorë si dhe krahasimi me çmimet në kapacitet industriale Ky mapim na jep një pasqyrë më të madhe për atë se lëvizën **konsumimi** në krahasim me **politikat e çmimeve**.

Në fotografinë 2 në vijim është dhënë analizë krahasuese e konsumit final të energjisë në vitin 2013 mes vendeve të BE-s dhe vendeve të rajonit sipas Eurostat-it. Janë krahasuar kategoritë e konsumimit final industrial të energjisë, transportit, amvisërive, etj. Duke e shqyrtuar konsumimin e energjisë për amvisëritë, Maqedonia në krahasim me vendet e rajonit ka relativitetin përqindje të ulët, por në krahasim me UE-n është më e madhe për rreth 2%. Duke analizuar këto kategori, autorët tregojnë se kategoritë e shqyrtuara në këtë analizë janë segment i rëndësishëm i konsumatorëve dhe si i tillë

duhet të trajtohet me vëmendje më të madhe. Qëllimi final është kursimi më i madh i mjeteve të cilat derdhen në atë drejtim.


Në fotografinë 3 është dhënë sqarim grafik i çmimit të energjisë elektrike për konsumatorë të kategorisë LV2, 2015/2014, nga EUROSTAT. **Kjo kategori i përfshin shkollat, amvisëritë dhe konsumatorët tjerë.** Analiza krahasuese tregon se ndryshimi i çmimit për konsumatorë të kategorisë LV2, për MK, gjegjësisht rritja prej vitit 2014 në 2015 është +5.06%, ndërsa në Letoni është +19,78%, ulje më të madhe ka në Shqipëri -29,63%. Rritja e konsumimit në kategorinë në fjalë është edhe një faktor i cili tregon se duhet të jetë një nga detyrat me prioritet për shqyrtim edhe të qeverisë por edhe më gjerë.

Analizë e ngjashme krahasuese është bërë edhe për industrinë. Ndryshimi i çmimit për industrinë në MK, gjegjësisht rritje nga 2014 deri 2015 është +10.85%, ndër rritjet më të mëdha në UE, ndërsa në Serbi është +21,82%, Qiproja ka ulje më të madhe prej -20,31%.

Në princip, ndryshimi i çmimit te këto vende mund të jetë edhe rezultat i rritjes së kërkesës për energji elektrike dhe zvogëlimit të ofertës si edhe rezultat i rritjes së prodhimit industrial. *Analizat vijuese në nivel të vendeve të UE-s tregojnë se rritja e energjisë elektrike vjen nga pozita monopole e furnizuesve të tregjeve.*

Fotografia 2.

Analizë e konsumimit final të energjisë (%), 2013, Eurostat




Fotografia 3. Grafik për çmimin e energjisë elektrike për konsumatorë të kategorisë LV2, 2015/2014, Eurostat



Fotografia 4.

Grafik për çmimin e energjisë elektrike në industri 2015/2014, Eurostat



POLITIKAT E UE-S PËR TREGUN E ENERJISË ELEKTRIKE

Siguria e sistemit energjetik dhe çmimi i furnizimit me energji, në veçanti energjia elektrike janë elemente kyçe në strategjinë energjetike për zhvillimin e një vendi. Çmimet e energjisë elektrike janë të rëndësishme të veçantë për konkurrencën ndërkombëtare. Energjia elektrike zakonisht është pjesë e rëndësishme e harxhimeve të përgjithshme për energji të bizneseve industriale dhe shërbyese. Për dallim nga çmimi i lëndëve djegëse me të cilat zakonisht tregtohet në tregjet botërore me çmime relativisht të unifikuara, për energjinë elektrike ka spektër më të gjerë të çmimeve në vendet e UE-s. Deri në një shkallë të caktuar çmimi i energjisë elektrike është nën ndikim të çmimit të lëndëve bazike djegëse.

UE vepron për tu liberalizuar tregu i energjisë elektrike dhe gazit që nga gjysma e dytë e viteve '90-ta. Direktivat e miratuara në vitin 2003 vendosën rregulla të përbashkëta për tregun e brendshëm për energji elektrike dhe gaz natyror. Afatet për hapjen e tregjeve u mundësojnë shfrytëzuesve ta zgjedhin furnizuesin e vet: nga 1 korriku 2004 për biznes klient dhe nga 1 korriku 2007 për të gjithë shfrytëzuesit (duke i përfshirë edhe konsumatorët e tjerë nga kategoria LV2). Disa vende të UE-s e zbatojnë procesin e liberalizimit ndërsa të tjerët shumë më ngadalë i sjellin masat e nevojshme.

Në fakt, pengesa të rëndësishme për pjesën më të madhe të vendeve të UE-s për hyrje në tregun liberal të energjisë elektrike dhe gazit natyror paraqesin **monopolet e furnizuesve apo pozitat që i kanë pas paraprakisht në treg dhe shfrytëzimi i tyre.**

Direktiva e dytë evropiane për tregun e brendshëm të energjisë kërkon liberalizimin e plotë të tregjeve të energjisë elektrike për konsumatorët industrial në vitin 2004 dhe për konsumatorët e kategorisë LV2 në vitin 2007. Megjithatë, sipas raportit të Institutit Bruno Leoni (Istituto Bruno Leoni, 2014) konkurrenca në tregun e energjisë elektrike me pakicë edhe më tutje vazhdon të jetë vetëm një ide e mirë në Unionin Evropian.

Shkak i rëndësishëm për mungesën e avancimit në këtë fushë është fakti se Komisioni Evropian nuk ka masa për implementimin e kësaj direktive duke pasur parasysh diskrecionin e gjerë që e kanë vendet anëtare në zbatimin e konkurrencës. Kjo le hapësirë për hamendje dhe kompromise politike të cilat kanë rezultuar me spektër të gjerë të rregullave në tregjet e gjitha shteteve.

ÇMIME TË RREGULLUARA TË ENERJISË ELEKTRIKE NË DISA SHTETE TË UE-S

Njëri nga zbulimet kryesore është ajo se disa vende anëtare (mes të cilave Italia, Franca, Spanja, Portugalia dhe Danimarka) mbajnë çmime të rregulluara apo oferta standarde (gjegjesisht oferta për shfrytëzuesit të cilët nuk transferohen dhe për të cilët organi publik blen energji elektrike në treg zakonisht me çmime të rregulluara). Të dy faktorët, çmimet e rregulluara dhe ofertat standarde krijuan pjesë të segreguara nga

tregu ku shfrytëzuesit të cilët nuk janë të kyçur në tregjet e lira dekurajohen të bëjnë një gjë të tillë (ACER/CEER, 2014).

MODELE TË MARA NGA BIZNIS SEKTORI

Shkaku pse konkurrenca në tregtinë me pakicë është aq e rëndësishme sepse e njëjta duhet të sjellë çmime më të ulëta. Ajo që është më e rëndësishme – mu për shkak të konkurrencës do të ndryshon raporti i operatorëve ndaj konsumatorëve. Konkurrenca në fakt është mjet për rritjen e spektrit të shërbimeve që kanë të bëjnë me energjinë elektrike për klientët dhe nënkuptohet çmim më të kaptshëm. Konkurrenca përfshinë mundësi për klientët të kenë liri gjatë zgjedhjes dhe furnizuesit të jenë më aktiv me biznes modele të reja.

Pos kësaj, në nivel më të lartë të konkurrencës politikat e çmimeve më shumë reflektohen në tregun e lirë. Nëse çmimet i reflektojnë harxhimet, konsumimi mund të transferohet në kohën kur çmimet janë më të ulëta gjegjësisht jashtë off-peak orëve, me çka kapacitetet do të shfrytëzohen në mënyrë më efikase.

LIRIA E ZJGEDHJES PËR KONSUMATORËT E TREGJEVE NË UE

Ofertat e furnizuesve me energji elektrike mund të dallojnë për nga lloji i çmimeve të mallrave (pa dallim a janë fikse, apo të bazuara në vend, të rregulluara ose të ndryshueshme), mundësia të zgjidhet ofertë për dy lëndë djegëse (gjegjësisht furnizim i përbashkët me energji elektrike dhe gaz natyror, sigurimi i shërbimeve plotësuese (për shembull mirëmbajtja e bojlerit, izolimi i shtëpisë, etj) dhe burimi i energjisë elektrike (shembull oferta të “gjelbërta”).

Të dhënat e prezantuara dhe analizat e bëra tregojnë se ekzistojnë përfitime të dukshme nga konkurrenca apo liberalizimi i tërë të cilët mund të fitohen në tregjet e energjisë elektrike. Për fat të keq, “politikat” inerte rezultojnë në konsumatorë inertë. Disa vende anëtare të UE-s derisa formalisht janë në pajtim me direktivat e UE-s akoma i presin barriera efektive për hyrje të konkurrencës së re. Këto barriera si edhe llojllojshmëria e madhe në skemat rregullatore e rrezikon integrimin e tregjeve evropiane dhe në një mënyrë paraqet pengesë për krijimin e “unionit energjetik” të rëndësishëm siç është përcaktuar nga ana e komisarëve Miguel Arijas Canete dhe Marot Shefçoviç.

HARXHIME DHE PËRFITIME NGA POLITIKA

Kjo CBA analizë e politikave publike nisat nga hipoteza se me daljen në tregun e lirë të energjisë elektrike, komunat do të mundën të furnizohen me energji elektrike nga operatorë të cilin vetë do ta zgjedhin. Sipas analizave tona çmimi i energjisë elektrike mundet të dallon prej 26% deri 40 % nga çmimi i tanishëm të cilin e paguajnë shkollat.

Gjatë analizës janë përdorur të dhëna të nga operatorët e energjisë elektrike – EVN, EDS (Energy Delivery Solutions) si edhe janë marrë çmimet mesatare të energjisë elektrike nga Raporti vjetor i Komisionit rregullator (Регулаторна комисија за енергетика на РМ, 2014). Autorët mendojnë se me uljen e harxhimeve për energji në ndërtesat publike shkollore si rezultat i liberalizimit të tregut të energjisë, në fillim do të kursehen para (si përfitim i parë). Pastaj pritet të rritet fleksibiliteti dhe komoditeti i shfrytëzuesve në raport me përdorimin e energjisë elektrike dhe do të rriten aktivitetet sociale dhe jashtë – shkollore nëpër shkolla. Përfitim është edhe mundësia që konsumatorët, gjegjësisht shkollat nevojat dhe kërkesat e veta ti adaptojnë sipas buxheteve të veta. Në përgjithësi me përmirësimin e kushteve hapësinore nëpër shkolla kemi rritjen e kualitetit të procesit arsimor në përgjithësi. Këto përfitime do të paraqiten si rezultat i fleksibilitetit të çmimeve të energjisë elektrike.

Duke dashur ti bëjmë kalkulimet reale në kornizat e dhëna kohore – financiare të projektit janë marrë të dhëna nga dy komuna në Maqedoni për faturat e energjisë elektrike në shkolla për vitet 2012, 2013, 2014 dhe një pjesë të 2015. Komunat nga të cilat arritëm ti marrim të dhënat janë Koçani dhe Krivogashani. Kjo përputhet me konceptin e paraparë që analizën ta bëjmë për një komunë rurale dhe një urbane për 3 vitet e fundit. Vlefshmëria e të dhënave është e lartë sepse janë marrë nga faturat e paguara për energji elektrike.

HARXHIME

Në fillim të theksojmë se në anën e harxhimeve i identifikojmë këto harxhime:

- TIP 1 – Harxhime direkte dhe materiale
- TIP 2 – Harxhime indirekte jomateriale
- TIP 4 - Investim

Nga kategoria TIP 3 – Huazim, nuk janë harxhime të identifikuara sepse vetë politika ka të bëjë ndryshimin e operatorit për furnizim me energji elektrike dhe nuk ka të bëjë me ndonjë investim.

Në këtë pjesë janë identifikuar **harxhimet direkte** të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e politikës së re.

(T1) Në pjesën e harxhimeve do ti cekim **harxhimet fillestare të Qeverisë për ti informuar vetëqeverisjet lokale** për mundësinë e implementimit të furnizimit të ri dhe eventualisht sesionet informative dhe promovimin e politikës së re para vetëqeverisjeve lokale. Pasi që kjo fushë është e rregulluar me ligj nuk ka nevojë për ndryshime plotësuuese ligjore përveç ndryshime në ndonjë nga rregulloret. Sipas përvojës së deritanishme dhe informatat nga raportet publike të Byrosë për furnizime publike për vitin 2014, një fushatë e tillë informative në nivel nacional do të kushtonte nga 25.000 EUR deri 35.000 EUR. Për nevojat e kësaj analize për fushatë informative – edukative nacional në kohëzgjatje prej 1-2 muaj do të marrim vlerë prej 2.000.000 MKD. Vlerën e ndajmë

me numrin e përgjithshëm prej 80 komunave. Operojmë me 2/80 prej 2.000.000 = 50.000,00 MKD për dy komuna Koçan dhe Krivogashtan (të cilat janë objekt i analizës).

Ajo që në disa komuna mund të shfaqet si parakusht jo i vulltshëm janë borxhet e mbetura për energji elektrike të disa shkolla. Megjithatë duke pasur parasysh se EVN-ja është e rregullt në mbledhjen e borxheve me siguri këto do jenë disa raste të izoluar. Me siguri do të nevojitet që komunat të cilat nuk i kanë mbuluar borxhet e mbetura për energji elektrike ti mbulojnë para se ta fillojnë me procedurën e furnizimit publik.

(T2) Këtu do të cekim edhe **harxhimet për ndryshimin e operatorit** të cilët janë të njëfishtë dhe i quajmë si investime. Këto harxhime në Maqedoni janë të barabartë me zero, por për shkak se ekzistojnë në shtete tjera autorët mendojnë se duhet të evidentohen si të tillë.

(T3) Tip tjetër i harxhimeve janë **harxhimet për shfrytëzimin e rrjetit për transferim të MEPSO-s (koeficient i rrjetit)**. Pasi bëhet fjalë për kompani shtetërore çmimin për transferim të energjisë elektrike e rregullon Komisioni rregullator dhe zakonisht shprehet me si% e neto çmimit të energjisë elektrike. Për të gjithë operatorët me energji elektrike kjo është përqindje e njëjtë që i shtohet neto çmimit të një kilovat ore. Kjo na sjell deri te konkludimi se megjithatë dallimi në çmim deri te konsumatori final në fakt do të jetë neto dallimi në çmimin bazik të energjisë elektrike pa TVSH dhe harxhimi për shfrytëzimin e rrjetit për transferim të MEPSO-s. Prandaj këtë harxhim si të tillë vetëm e evidentojmë por me vlerë e quajmë si zero. Si mbështetje për këtë të dhënë në tabelën në vijim janë dhënë llojet e ndryshme të kyçjeve edhe atë për kategoritë industriale, ndriçimet publike si edhe kategoritë tjera. Ne e shqyrtojmë kategorinë LV2 e cila kategori i përfshinë shkollat, institucionet publike dhe amvisëritë.

(T4) Si **harxhime direkte** në çdo vetëqeverisje lokale do të jenë **harxhimet për zbatimin e procedurës së tenderimit** për furnizim me energji elektrike në sistemin elektronik për furnizime publike – SEFP. Ky harxhim për operatorët ekonomik është 4720 MKD parapagesë vjetore sipas informatave publike nga çmimorja e Byrosë për furnizime publike, ndërsa për organet siç janë komunat dhe institucionet tjera është 600+TVSH 18% (708 MKD.) dhe për procese të tenderimit mbi 20.000 EUR është 900MKD. +TVSH 18% (1062 MKD.). Në analizë i fusim të dy shumat si harxhim vjetor.

Fotografia 5. Sistemi tarifor i EVN-s për konsumatorë të ndryshëm

Tarifa për llogaritjen e elementeve (me tarifë të kalkuluar për shpërndarje të energjisë elektrike)						
Njësia llogaritëse	Njësia	MV1	MV2	LV1.2	LV1.1	LV2
Fuqia aktive	kW	95.50	128.28	184.38		
Energjia elektrike aktive	kWh	0.2687	0.3205	0.3741	0.9445	2.2608
Konsumimi më i tepërt i energjisë elektrike reaktive	kVArh	0.0090	0.0297	0.0512		

(T5) Harxhime për përgatitjen e dokumentacionit për tender për furnizim me energji elektrike nëpërmjet Sistemit elektronik të Byrosë për furnizime publike (SEFP). Do të angazhohet me kontratë në vepër **një ekspert për tenderë dhe një për energjetikë** dhe atë në fillim të procedurës, njëherë në vit. Për këtë është përcaktuar shumë prej 60.000,00 MKD në vit, sipas informatave të subjekteve tjera publike (Qendra për zhvillim të Rajonit të Shkupit) të cilët kanë shfrytëzuar kesi lloj shërbimesh gjatë më shumë viteve. Këtë shumë e planifikojmë një herë në vit edhe atë vetëm vitin e parë.

(T6) Në këtë pjesë janë edhe **harxhimet për të punësuarit në vetëqeverisjen lokale** të cilët do të duhet ta përgatisin dokumentacionin për tenderim, sepse ky proces do të bëhet për herë të parë. Më së shpeshti ai është person **i punësuar në komunë për furnizime publike**. Sipas të dhënave të komunës Gazi Babë supozojmë se ky person i punësuar në pozitën udhëheqës i departamentit apo sektorit do të duhet të ketë rreth 30.000,00 denarë neto rrogë gjegjësisht 44.547,00 MKD. Në analizën tonë supozojmë se shprehur në përqindje kjo është **20%** nga koha e tij dhe prandaj kjo shumë do të jetë 8.909,00 MKD në nivel mujor. Në analizën tonë këtë shumë e marrim për të dyja komunat $2 \times 8.909,00 = 17.818,00$ MKD njëherë në vit.

(T7) Ngjashëm i caktojmë edhe **harxhimet për person të punësuar në komunë për energjetikë** i cili do të ndihmon në përgatitjen e procedurës për tenderim dhe më vonë do ta kontrollojë marrëveshjen me operatorin e ri. Për atë person marrim se do të jetë **20%** dhe atë nga shuma prej 44.547,00 MKD në bazë mujore. Në analizën tonë këtë shumë e marrim për të dy komunat $2 \times 8.909,00$ MKD = 17.818,00 MKD shumëzuar me 12 muaj = 213.816,00 MKD.

(T8) Caktojmë edhe **një person për mbikëqyrje të kualitetit në vetë shkollat** dhe monitorimin e dhënies së faturave nga operatori i ri. Në analizën tonë supozojmë se kjo është **20%** nga koha e tij dhe prandaj kjo vlerë do të jetë 8.909,00 MKD në nivel mujor. Në analizën tonë këtë shumë e marrim për të dy komunat $2 \times 8.909,00 = 17.818,00$ MKD një herë në vit.

PËRFITIME

Duke marrë parasysh përvojën nga biznes sektori me fillimin e liberalizimit të tregut për energji elektrike, si dhe përfitimet që janë evidentuar atje, ekipi i hulumtuesve bëri analogji të ngjashme me përcaktimin e përfitimeve të institucionet publike gjegjësisht shkollat.

Sipas kategorive këtu janë identifikuar përfitimet në vijim:

- TIP 1 – Përfitime direkte dhe materiale
- TIP 2 – Përfitime indirekte dhe jomateriale

Nga kategoria TIP 3 – Para nga huazimi nuk ka sepse nuk ka ashtu lloj harxhimesh. Për kategorinë TIP 4- Kthimi i parave nga investimi gjithashtu nuk janë evidentuar përfitime.

Ajo që është dhënë këtu janë dy opsione të përfitimeve Varianti A dhe Varianti B.

Në **Variantin A** është përdorë çmimi i energjisë elektrike nga EVN dhe EDS si operatorë ekonomik dhe rrjedhimisht është fituar dallim në çmim prej 29,56% (në favor të EDS)

Në **Variantin B** janë marrë çmimet e EVN dhe çmimi mesatar i pesë operatorëve në tregun e lirë për energji elektrike në vitin 2014 (GÉN-I, EDS, EFT, ENERGY SUPPLY-M, EVN TRADING) dhe është fituar dallim në çmim prej 36,98% (në favor të operatorëve të lirë).

(P1) Në pjesën e analizës së përfitimeve fillojmë nga ajo se politika e këtillë publike për dalje të komunave në tregun liberal të energjisë elektrike së pari dhe më me rëndësi do të sjell kursimin e parave. Në kalkulimet për atë se sa mund të jetë ai kursim u nisëm nga të dhënat krahasuese të mara nga operatori në tregun e lirë të energjisë elektrike Energy Delivery Solutions (EDC)². Analiza krahasuese tregon se furnizimi mes modelit tarifor të tanishëm dhe modelit të ri të furnizimit në tregun e lirë do të sjell **kursim në harxhime prej 29,56%**. Nëse i krahasojmë harxhimet kumulative vjetore në komunën e Koçanit³ ku ka 10 ndërtesa shkollore (9 shkolla fillore dhe 1 shkollë të mesme) për vitin 2014 ata janë 1.098.597,00 MKD. Kjo shumë me operatorin tjetër do të ishte më e ulët për rreth 30 %, gjegjësisht faturat gjithsej do të jenë 773.851,73 MKD. Përfitimet direkte materiale do të jenë 324.745,27 MKD gjegjësisht 5.280,41 EUR (61,6 MKD. = 1 EUR).

Në bazë të të dhënave të fituara nga komuna për faturat e energjisë elektrike për vitet 2012, 2013 dhe 2014 kemi kursim 3 vjetor kumulativ (përfitime) prej 1.079.344,23 MKD apo 17.550,31 EUR. Për të qenë statistikisht korrekt në përfitimet vjetore do ta marrim mesataren e kursimit nga tre vitet, gjegjësisht do të punojmë me **359.781,41 MKD kursim** (përfitim) në nivel vjetor.

Sipas së njëjtës analogji për komunën e Krivogashtanit kemi prezantua të dhëna tabelore në Shtojcën 2 për tre vite 2013, 2014 dhe 2015. Kjo komunë rurale ka 1 ndërtesë shkollore. Fatura vjetore për energji elektrike për vitin 2015 është 93.086,00 MKD. Kjo shumë me operatorin tjetër do të ishte më e ulët për 29,56 %, gjegjësisht këtu faturat do të ishin gjithsej 65.569,78 MKD. Përfitimet direkte materiale për komunën do të ishin 27.516,22 MKD gjegjësisht 447,42 EUR (61,6 DEN = 1 EUR).

Në bazë të të dhënave të mara nga komuna për fatura për energji elektrike për ndërtesën shkollore për vitet 2013, 2014 dhe 2015 kemi kursim (përfitim) 3 vjetor kumulativ prej 88.462,14 DEN apo 1.438,41 €. Për të qenë statistikisht korrekt në përfitimet vjetore do ta marrim mesataren e kursimit nga tre vitet, gjegjësisht do të punojmë me **29.487,38 MKD kursim** (përfitim) në nivel vjetor. **Shuma e kursyer në të dy komunat do të jenë përfitimet në nivel vjetor në CBA analizën, gjegjësisht 389.268,79 MKD.**

Në të njëjtën këtë pjesë është bërë analizë dhe kalkulim nëse merret çmimi mesatar nga Raporti vjetor i Komisionit Rregullator (Shih Shtojcën 4) dhe e cila është madje më e ulët se çmimet e kalkuluara më lartë edhe atë për 5.483165 MKD për kilo vat orë, fitohet 36,98% çmim më i ulët se çmimi i sistemit tarifor të EVN-s.

2 Shih Shtojcën 3. Kalkulime të EDS-s për çmimin e energjisë elektrike.

3 Në Shtojcën 1 është dhënë prezantim tabelar për vitet 2012, 2013 dhe 2014 sipas shkollave dhe faturave kumulative vjetore për energji elektrike sipas modelit të tanishëm tarifor

Në këtë rast kemi kursim prej 418.073,83 MKD për dy komunat.

(P2) Pastaj pritet se do të rritet fleksibiliteti dhe komoditeti i nxënësve dhe personelit shkollor, arsimdhënësve nga aspekti i shfrytëzimit të kushteve hapësinore, pastaj pritet se (P3) do të rriten edhe aktivitetet sociale dhe jashtë-shkollore në shkolla. Si përfitim final jomaterial është rritja e kushteve në nivel hapësinor, në shkolla kemi (P4) rritje të kualitetit të procesit shkollor në tërësi. Kjo hap mundësi që konsumatorët – gjegjësisht shkollat ti përshtatin nevojat dhe kërkesat e veta sipas buxheteve për energji elektrike. Për këtë përfitim nuk kemi përcaktuar vlerë materiale.

REZULTATE NGA ANALIZA E HARXHIMEVE DHE PËRFITIMEVE

Në shembullin e dhënë nga ana e donatorëve janë futur harxhimet dhe përfitimet e lartpërmendura. Periudha e “CBA analizës” është bërë për 10 vjet (dhe po ashtu janë dhënë edhe rezultatet kumulative për 20 vjet), duke e marrë vitin 2014 për të cilin kishim të dhëna të plota “CBA analiza” fillon me 2105 dhe mbaron me vitin 2024. Periudha kohore e mbuluar me “CBA analizën” përputhet mirë me 2 mandatet e ardhshme të kryetarëve të komunave 2017-2020 dhe 2021 – 2024. Kjo në veçanti është mirë sepse mundëson kontinuitet në mbledhjen dhe ndjekjen e të dhënave nga komunat. Pjesa për tendencat në tre vitet e fundit është dhënë në kapitullin paraprak.

Norma e skontimit është marrë 8.90%.

Në pjesën e analizës autorët menduan se do të ishte mirë që për ilustrim të njehsohet si të dhënat e fituara nga analiza e dy komunave mundet të shërbejnë si motivim për tu përpunuar të dhënat për gjithë vendin dhe të shihet niveli i përgjithshëm i përfitimeve dhe politikave. Për këtë njehsojmë njësi matëse krahasuese dhe kjo do të ishte kursimi mesatar në nivel vjetor për krye të nxënësit. Për 2 komunat numri i nxënësve në vitin 2014/2015 është 5.130. Nga njehsimet e më lartme kursimi mesatar vjetor nga furnizimi me energji elektrike në tregun e lire në variantin A është 389.268,79 MKD gjegjësisht 6.329,57 EUR dhe në variantin B 418.073,83 MKD gjegjësisht 6.797,94 EUR . Nëse këtë shumë e ndajmë me numrin e nxënësve atë vit do të fitojmë prej **1,23 EUR – 1.32 EUR kursim për krye të nxënësit.**

Atë që duam ta tregojmë është se në nivel vjetor për gjithë vendin mjetet e kursyera do të ishin: 275.687 gjithsej nxënës ka në Maqedoni në shkollat fillore dhe të mesme, nëse ky numër shumëzohet me kursimin prej 1,23EUR - 1.32 EUR do të fitohet shuma prej 20.919.129,56 MKD – 22.467.352,35 MKD gjegjësisht 340.152,28 EUR – 365.322,81 EUR në vjet.

Nga vetë analiza për pjesën e harxhimeve kemi rezultate në tabelën në vijim:
Fotografia 6. Tabela nga CBA analiza për harxhimet

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Harxhime Koçan dhe Krivogashtan										
Tip 1 - indirekte - materiale										
harxhime për ndrimin e operatorit	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD
harxhime për shfrytëzimin e rrjetit distributiv të MEPSO-s	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD	MKD
Harxhime për zbatimin e procedurës për tender për furnizim me energji elektrike	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD	1.770.00 MKD
Harxhime për person të punësuar në komunë për furnizime	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD
Harxhime për person të punësuar në komunë për arsim	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD	17.818.00 MKD
Harxhime për person të punësuar në komunë për energjetikë	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD	213.816.00 MKD
Tip 2 - Indirekte - jomateriale										
Tip 2 - Huazim (nëse ka)										
Tip 4 - Para të dhëna si investim (nëse ka)										
Harxhime për përgatitjen e dokumentacionit për tender për furnizim me energji elektrike (një ekspert për tender dhe një për energjetikë fushatë nacionale	60.000.00 MKD									
informative - edukative për zgjidhjen e operatorit për furnizim me energji	50.000.00 MKD									
Gjithsej Harxhime	361.222	251.222	251.222	251.222	251.222	251.222	251.222	251.222	251.222	251.222

Në pjesën për përfitimet për Variantin A janë dhënë vlerat në vijim:
Fotografia 7. Tabela e CBA analizës për përfitimet për Variantin A

Përfitime							
Tip 1 - Direkte - materiale							
Kursime në nivel vjetor për faturat e energjisë elektrike për shkollat	389.268,79 MKD	389.268,79 MKD	389.268,79 MKD	389.268,79 MKD	389.268,79 MKD	389.268,79 MKD	389.268,79 MKD

Tip 2 - Indirekte - jomateriale							
flexibilitet i rritur dhe komoditet për nxënësit dhe personelin shkollor në raport me shfrytëzimin e kushteve hapësinore							
do të rriten aktivitetet sociale dhe jashta - shkollore nëpër shkolla							
rritja e kualitetit të procesit arsimor në shkolla							

Tip 3 - Para të fituara nga huazimet (nëse ka)

Tip 4 - Kthimi i parave nga investimet (nëse ka)

Gjithsej përfitime	389.269	389.269	389.269	389.269	389.269	389.269	389.269
---------------------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------

Rezultatet kumulative nga analiza e harxhimeve dhe përfitimeve i japin vlerat të prezantuara në tabelën në vijim:

Fotografia 8. Tabela nga CBA analiza për rezultatet kumulative varianti A

Neto (Përfitime - Harxhime)	28.047	138.047	138.047	138.047	138.047	138.047	138.047
Neto vlera e tanishme (Diskontuar)	28.047	126.727	116.373	106.848	98.151	90.007	82.690
Norma e diskontuar (8.90%)		0,918	0,843	0,774	0,711	0,652	0,599
							0,55
							0,505
							0,464

Gjithsej neto vlera e tanishme (10 vjet)

858.536

Gjithsej Netto vlera e tanishme (20 vjet)

1.296.007

Autorët japin edhe një analizë të Variantit B të përfitimeve me çmimet mesatare të mara nga Raporti vjetor i Komisionit rregullator për vitin 2014 dhe për këtë është dhënë tabela e më poshtme në fotografinë 10.

Në pjesën e përfitimeve për Variantin B janë dhënë vlerat në vijim:

Fotografia 9. Tabela e CBA analizës për përfitimet në Variantin B

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Përfitime										
Tip 1 - Direkte - materiale										
Kursime në nivel vjetor për faturat e energjisë elektrike për shkollat	418073,83	418073,83	418073,83	418073,83	418073,83	418073,83	418073,83	418073,83	418073,83	418073,83
Tip 2 - Indirekte - jomateriale										
flexibilitet i rritur dhe komoditet për nxënësit dhe personelin shkollor në raport me shfrytëzimin e kushteve hapësimore do të rriten aktivitetet sociale dhe jashta - shkollore nëpër shkolla										
rritja e kualitetit të procesit arsimor në shkolla										
Tip 3 - Para të fituara nga huazimet (nëse ka)										
Tip 4 - Kthimi i parave nga investimet (nëse ka)										
Gjithsej përfitime	418.074	418.074	418.074	418.074	418.074	418.074	418.074	418.074	418.074	418.074

Rezultatet kumulative nga analiza e harxhimeve dhe përfitimeve i japin vlerat të prezantuara në tabelën në vijim:

Fotografia 10. Tabela e CBA analizës për rezultatet kumulative varianti B

Neto (Përfitime - Harxhime)	56.852	166.852	166.852	166.852	166.852	166.852	166.852	166.852	166.852	166.852
Neto vlera e tanishme (Diskontuar)	56.852	153.170	140.656	129.143	118.632	108.787	99.944	91.769	84.260	77.419
Norma e diskontuar (8.90%)		0,918	0,843	0,774	0,711	0,652	0,599	0,55	0,505	0,464
Gjithsej neto vlera e tanishme (10 vjet)	1.060.632									
Gjithsej Netovlera e tanishme (20 vjet)	1.589.386									

KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Ajo çka mund të konkludohet nga kjo analizë është se që në vitin e parë përfitimet janë më të mëdha se harxhimet. Nëse përpunohen të dy variantet A dhe B neto vlera e përgjithshme e tanishme me normën e skontimit prej 8,9%, atëherë për 10 vjet fitohen 858.536,00 MKD – 1.060.632,00 MKD gjegjësisht 13.595,00 – 17.246,06 EUR apo për 20 vjet fitohen 1.296.007,00 – 1.589.386,00 MKD gjegjësisht 21.073,00 – 25.843,67 EUR.

Shohim se që në vitin e parë vetëm përfitimet materiale gjegjësisht kursimi i mbulon të gjitha harxhimet madje edhe ato që janë të njëfishtë. Në vitin e dytë kursimi arrin prej 138.047,00 – 166.852,00 MKD.

Rekomandimet janë dhënë në drejtim të implementimit të ndryshimit të operatorit dhe mjetet e kursyera të investohen në disa kategori. Gjegjësisht për 10 vite mund të përfshihen të gjitha masat e propozuara. Nga të dhënat nga komuna e Gazi Babës – Shkup, Sektori për ndërtimtari, punë komunale dhe efikasitet energjetik dhe Departamentit për

Fotografia 11. Numri i përgjithshëm i nxënësve sipas komunave në vite shkollore

Nxënës në shkolla sipas komunave dhe viti shkolror			
	2012/2013	2013/2014	2014/2015
Republika e Maqedonisë	285195	277469	275687
Koçani	4853	4698	4569
Krivogashtani	578	574	561
2 komunat	5431	5272	5130

arsim, mjetet e kursyera vjetore mund të dedikohen për investim në kategoritë në vijim:

A. Kategori për efikasitet energjetik të cilët sjellin kursim 20-40% në mjete/harxhime për ngrohje:

- Ndrimi i bojlerit nga dru në peleta
- Dritare (për 2 klasa)
- pullaz (për 2 klasa)
- izolim i fasadës (për 4 klasa)

B. Kategori të cilat dukshëm e avancojnë kualitetin e procesit arsimor:

- banka dhe ulëse të reja për 3 klasa
- laboratorë për 3 lëndë mësimore
- një klasë me 24 kompjuterë dhe printer
- smart tabelë

C. Kategori të cilët e avancojnë jetën arsimore dhe sportive të të rinjve:

- fushë futbollit dhe basketbollit me pajisje të tërë
- gjelbërimi dhe rregullimi i kopshtit në shkolla

Pasi në fillim cekëm se bëhet fjalë për mjete të cilat nëpërmjet bllok granteve transferohen nga buxheti qendror në komuna, shumica e pareve është fikse. Këto pare janë qëllimore dhe mund të harxhohen vetëm për shkolla. Komuna gjegjësisht Sektori për arsim duhet të propozon masa për kursim – gjegjësisht blerjen e energjisë elektrike nga operatori i lirë. Me parat e kursyera që në vitin e dytë sektori i njëjtë mundet të propozon ndërrim fazor apo investim në modernizim të shkollave.

Kjo analizë edhe pse sipas vëllimit është e vogël dhe ka të bëjë me studimin e dy komunave, një urbane dhe një rurale, ka dhënë kontributin e vet sepse duhet të kuptohet si nxitje për zgjerimin e analizës në nivel shtetëror në të gjitha komunat dhe të gjitha ndërtesat shkollore. Kjo analizë zbaton alternativa të reja të mendimit në procesin e sjelljes së vendimeve nga personat përgjegjës dhe nëpërmjet metodave të reja të analizës së harxhimeve dhe përfitimeve hapën mënyra më efektive të harxhimit të parave publike të dedikuara për furnizim me energji elektrike në ndërtesat shkollore.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Министерство за финансии (2004) *Закон за финансирање на единициите на локална самоуправа.*
- [2] Непознат автор (2013) Најголеми енергетски трошоци се болниците, училиштата. *Вечер. 15 јули 2013.* [на интернет] Достапно на: <http://vecer.mk/ekonomija/najgolemi-energetski-troshadhii-se-bolnicite-uchilishtata>
- [3] Регулаторна комисија за енергетика на РМ (2014) *Годишен извештај 2014 година.*
- [4] Службен весник на РМ бр. 162/2009. *Правилник за ѝазарои на елекѝрична енерѝија.*
- [5] Службен весник на РМ бр. 16/2011. *Закон за енерѝеѝика.*
- [6] Фити, Т. (2009) *Економија.* Економски факултет – Скопје.
- [7] ACER/CEER (2014) *Annual report on the results of monitoring the internal electricity and natural gas markets in 2013.*
- [8] Instituto Bruno Leoni (2014) *Index of liberalizations 2014.*

SHTOJCA

1

PREZANTIM TABELAR I KONSUMIMIT TË ENERGIJE ELEKTRIKE NË SHKOLLA NË KOMUNËN E KOÇANIT (10 NDËRTESA SHKOLLORE)

Nr.	Emri i shkollës	Viti	Harxhimi vjetor i energjisë (kWh)	Harxhime vjetore për energji (€)	Harxhime vjetore për energji (mkd)*	Çmimi mesatar (mkd/kWh)
1.	SHF KP Misirkov Orizare	2012	26.400	4.097 €	251.965,50 MKD	9,54 MKD
		2013	26.400	4.097 €	251.965,50 MKD	9,54 MKD
		2014	26.400	4.097 €	251.965,50 MKD	9,54 MKD
		Gjithsej:	79.200	12.291 €	755.896,50 MKD	9,54 MKD
2.	SHF Malina Popivanova	2012	32.900	5.470 €	336.405,00 MKD	10,23 MKD
		2013	34.400	4.307 €	264.880,50 MKD	7,70 MKD
		2014	21.858	3.134 €	192.741,00 MKD	8,82 MKD
		Gjithsej:	89.158	12.911 €	794.026,50 MKD	8,91 MKD
3.	SHF Nikola Karev - Koçan	2012	4.337	690 €	42.435,00 MKD	9,78 MKD
		2013	4.127	640 €	39.360,00 MKD	9,54 MKD
		2014	2.130	340 €	20.910,00 MKD	9,82 MKD
		Gjithsej:	10.594	1.670 €	102.705,00 MKD	9,69 MKD
4.	SHF Rade Kratovçe - Koçan	2012	40.928	6.720 €	413.280,00 MKD	10,10 MKD
		2013	40.270	6.594 €	405.531,00 MKD	10,07 MKD
		2014	34.875	5.711 €	351.226,50 MKD	10,07 MKD
		Gjithsej:	116.073	19.025 €	1.170.037,50 MKD	10,08 MKD
5.	SHF Gosho Vikentiev**	2012	18.502	2.708 €	166.518,00 MKD	9,00 MKD
		2013	18.270	2.674 €	164.430,00 MKD	9,00 MKD
		2014	19.306	2.825 €	173.754,00 MKD	9,00 MKD
		Gjithsej:	56.078	8.207 €	504.702,00 MKD	9,00 MKD
6.	SHF Qiril dhe Metodij Koçan**	2012	12.000	1.756 €	108.000,00 MKD	9,00 MKD
		2013	12.000	1.756 €	108.000,00 MKD	9,00 MKD
		2014	12.000	1.756 €	108.000,00 MKD	9,00 MKD
		Gjithsej:	36.000	5.268 €	324.000,00 MKD	9,00 MKD
Gjithsej:			387.103	59.372 €	3.651.367,50 MKD	

*Kursi mesatar 1€ = 61,5 MKD

** janë dhënë vetëm vlerat e konsumimit vjetor të energjisë (kWh)

Njehsim sipas vlerës mesatare nga nr. 1-4 nga çmimi mesatar (MKD/kWh)

SHTOJCA

2

PREZANTIM TABELAR I KONSUMIMIT TË ENER-GJISË ELEKTRIKE NË SHKOLLA NË KOMUNËN E KRIVOGASHTANIT (1 NDËRTESTË SHKOLLORE)

2013			
Muaji	kWh	Shuma (den)	Çmimi (mkd/kWh)
Janar	1060	9.192,00 MKD	8,67 MKD
Shkurt	1336	11.600,00 MKD	8,68 MKD
Mars	1250	10.545,00 MKD	8,44 MKD
Prill	985	8.550,00 MKD	8,68 MKD
Maj	983	8.532,00 MKD	8,68 MKD
Qershor	950	8.245,00 MKD	8,68 MKD
Korrik	434	3.636,00 MKD	8,38 MKD
Gusht	500	4.200,00 MKD	8,40 MKD
Shtator	914	7.700,00 MKD	8,42 MKD
Tetor	1185	9.970,00 MKD	8,41 MKD
Nëntor	1171	9.952,00 MKD	8,50 MKD
Dhjetor	1250	10.545,00 MKD	8,44 MKD
Gjithsej:	12018	102.667,00 MKD	8,54 MKD
		1.669,38 €	Çmimi mesatar (mkd/kWh)
2014			
Muaji	kWh	Shuma (den)	Çmimi (mkd/kWh)
Janar	998	8.396,00 MKD	8,41 MKD
Shkurt	1354	11.391,00 MKD	8,41 MKD
Mars	1240	11.282,00 MKD	9,10 MKD
Prill	1042	8.767,00 MKD	8,41 MKD
Maj	1195	10.053,00 MKD	8,41 MKD
Qershor	961	8.085,00 MKD	8,41 MKD
Korrik	695	5.853,00 MKD	8,42 MKD
Gusht	478	4.000,00 MKD	8,37 MKD
Shtator	826	7.182,00 MKD	8,69 MKD
Tetor	486	4.300,00 MKD	8,85 MKD
Nëntor	1248	10.851,00 MKD	8,69 MKD
Dhjetor	1535	13.350,00 MKD	8,70 MKD
Gjithsej:	12058	103.510,00 MKD	8,58 MKD
		1.683,09 €	Çmimi mesatar (mkd/kWh)
2015			
Muaji	kWh	Shuma (den)	Çmimi (mkd/kWh)
Janar	777	6.533,00 MKD	8,41 MKD
Shkurt	1620	10.647,00 MKD	6,57 MKD
Mars	659	4.044,00 MKD	6,14 MKD
Prill	1270	8.021,00 MKD	6,32 MKD
Maj	1140	7.104,00 MKD	6,23 MKD
Qershor	1197	7.106,00 MKD	5,94 MKD
Korrik	1401	8.636,00 MKD	6,16 MKD
Gusht	1401	8.636,00 MKD	6,16 MKD
Shtator	1270	8.021,00 MKD	6,32 MKD
Tetor	659	4.044,00 MKD	6,14 MKD
Nëntor	1620	10.647,00 MKD	6,57 MKD
Dhjetor	1520	9.647,00 MKD	6,35 MKD
Gjithsej:	14534	93.086,00 MKD	6,40 MKD
		1.513,59 €	Çmimi mesatar (mkd/kWh)

SHTOJCA

3

KALKULIME TË EDS-S PËR ÇMIMIN
E ENERJISË ELEKTRIKE

Nëpërmjet kalkulimeve krahasuese të të dhënave të mara nga prezantimet publike të EDS-s për kategorinë – shkolla është dhënë tabela në vijim:

Për kategori konsumatorësh LV2	Çmime në denarë/kWh		Çmime në EUR/MWh
Tregu tarifor			
Çmimi i tanishëm (i cili vlen edhe pas 1 janarit)	8,7000	Çmimi i energjisë elektrike ndaj EVN	141,4634

Tregu i lirë			
Çmimi nga EDS	3,69	Neto çmimi nga operator tjetër (EDS)	60,0000
Çmimi i rrjetit ndaj operatorit të rrjetit	2,3780	Koeficient i cili shumëzohet me çmimin e energjisë el.	38,6667
Pjesa për treg ndaj operatorit	0,0603	Koeficient për treg, pjesë fikse i cili shumëzohet me sasinë e energjisë elektrike	0,9805
Çmimi i përgjithshëm në tregun e lirë	6,1283	Çmimi i përgjithshëm nëpërmjet operatorit tjetër (EDS)	99,6472

Kursimi	29,56%	% i uljes së çmimit aktual të energjisë elektrike
----------------	---------------	--

Gjitha shumat janë dhënë pa TVSH

SHTOJCA

4

KALKULIMI I ÇMIMEVE MESATARE TË ENERGJISË EL. NGA OPERATORË TJERË – FURNIZUES NË BAZË TË ÇMIMIT MESATAR TË MARË NGA KOMISIONI RREGULLATOR – RAPORTI VJETOR 2014

Për kategori konsumatorësh LV2	Çmime në denarë/kWh	Çmime në EUR/MWh
Tregu tarifor		
Çmimi i tanishëm (e cila vlen edhe pas 1 janarit)	8,7000	141,4634

Tregu i lirë		
Çmimi nga EDS	3,044865	49,5100
Çmimi i rrjetit ndaj operatorit të rrjetit	2,3780	38,6667
Pjesa për treg ndaj operatorit	0,0603	0,9805
Çmimi i përgjithshëm në tregun e lirë	5,483165	89,1572

Kursim	36,98%
---------------	---------------

Gjitha shumat janë dhënë pa TVSH